

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ME SELI NË TIRANË

“Prospera Finance & Consulting” SH.P.K

Në bazë të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe atij nr. 9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me vullnetin tim të lirë, ne, Avis Andoni, e datëlindjes 26.12.1985, e bija e Andreas, lindur dhe banuese në Tiranë me adresë; Residenza Kodra e Diellit, me nr. Personal I56226044O e pajisur me letërnjoftimin nr. 035850460, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, dhe Etleva Dharmo e datëlindjes 11.07.1967, e bija e Pëllumbit, lindur dhe banuese në Tiranë me adresë; Rruga Zef Jubani, me nr. Personal G75711083E e pajisur me letërnjoftimin nr. 036043241, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar sot më **datë 01.11.2023 në Tiranë**, shpallin si vijon:

NENI 1

Formohet Shoqëria Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar me emër **“Prospera Finance & Consulting” SH.P.K.** Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **“Prospera Finance & Consulting” SH.P.K.**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fushën financiare, kontabilitare dhe të konsulencës.

Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **“Prospera Finance & Consulting” SH.P.K.** Ajo do të ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

-Sherbime të mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore dhe hartimi i pasqyrave financiare të shoqërive të ndryshme, përfshirë dhe ato të personave fizike.

-Pergatitja e raporteve periodike sipas nevojave të drejtimit të biznesit.

- Sherbime lidhur me ngritjen e sistemeve kontabel dhe te kontrollit te brendshem prane shoqerive, permiresimi dhe mirembjatta e tyre, si dhe trajnimin profesional te personelit te ngarkuar me funksionimin e ketyre sistemeve.
- Sherbime te kontrollit te brendshem.
- Konsulenca fiskale per njohjen dhe zbatimin e legjislacionit fiskal.
- Sherbime te tjera te lidhura me shoqerite tregtare si: ndarje, bashkim, perthithje, administrim, likuidim, falimentim, rritje dhe zvogelim kapitali.
- Asistenca per praktika te ndryshme doganore dhe administrative prane institucioneve shteterore.
- Perfaqesimi i njesive ekonomike per qellime tatimore, gjyqesore apo kundrejt paleve te treta.
- Realizimin e kontratave, marreveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo formave te lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizike dhe juridike, shqiptar ose te huaj, per te realizuar operacione tregtare dhe veprimtari te ndryshme qe jane te nevojshme dhe me interes per shoqerine si dhe per cdo lloj aktiviteti qe do ti sherbeje realizimit te objektit.
- Ofrimi i sherbimeve te mbajtjes se selise per njesi te tjera ekonomike.
- Shoqeria mund te kryej cdo operacion tjeter te pajtueshem me profesionin e Kontabilistit te Miratuar duke perjashtuar cdo veprimtari qe do te shmangte shoqerine nga karakteri profesional apo cdo veprimtari qe bie ne kundërshtim me ligjin Nr.10091, date 5.3.2009 ‘‘ Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar’’.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës, në adresën Rruga Ukraina e Lirë, Pallati Teknoprojekt, kati 5.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë nominale 2,000,000 (dymilion) leke.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare ‘‘**Prospera Finance & Consulting**’’ SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

1. Znj. Avis Andoni, zotëron 1(një) kuotë me vlere nominale 1,800,000 (nje milion e teteqind mije) ose 90%, te kapitalit te shoqerise.
2. Znj. Etleva Dhamo, zotëron 1 kuotë me vlere nominale 200,000 leke (dyqind mije) leke ose 10% te kapitalit te shoqerise.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Znj. Etleva Dhama shtetase shqiptare, e datëlindjes 11.07.1967, lindur dhe banuese në Tirane me adresë; Rruga Zef Jubani, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, me nr. Personal G75711083E e pajisur me letërnjoftimin nr. 036043241.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj. Ortakët mund të shesin te tretëve kuotat e tyre te kapitalit pjesërisht ose tërësisht. Shitja e kuotave tek te tretet do te behet vetëm pasi të ketë marre vendim asambleja e ortakeve me 100% te votave.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Ky Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKET THEMELUES

Avis ANDONI

Etleva DHAMO